



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i dosjes: KSC-CC-2019-05

Vendos: **Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese**

Gjykatëse An Pauër-Ford, kryetare

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Roland Dekers

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 15 shkurt 2019

Në vëmendje të: **Parashtruesit**

z. Mahir Hasani

PUBLIK

Njoftim për tërheqjen e Urdhrit dhe Kërkesë për hedhjen poshtë të referimit të z.

Mahir Hasani

1. Më 11 shkurt 2019, ashtu siç u kërkua, z. Mahir Hasani ('Parashtruesi') u paraqit për marrje në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ('ZPS'). Për rrjedhojë dhe duke marrë parasysh hetimet në vijimësi të ZPS-së, materialet që kërkoheshin në Urdhrin për paraqitjen e dokumenteve dhe të dhënave të datës 20 dhjetor 2018 ('Urdhër për Paraqitjen e Materialeve'), nuk kërkohen më. ZPS-ja njofton Parashtruesin dhe Panelin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese¹ ('Paneli') për tërheqjen e Urdhrit për Paraqitjen e Materialeve.

2. Rrjedhimisht, tani Referimi² nuk ka më objekt shqyrtimi duke qenë se (i) rrethanat për të cilat u paraqit ankesë në Referim nuk ekzistojnë më; dhe (ii) çdo ndikim i mundshëm i çfarëdo cenimi të pretenduar të të drejtave të Parashtruesit është ndrequr me Urdhrin për Masë të Përkohshme³ dhe tërheqjen prej ZPS-së të Urdhrit për Paraqitjen e Materialeve.⁴ Për këto arsye, ZPS-ja i kërkon Panelit që ta hedhë poshtë Referimin.

Xhek Smith
Prokuror i Specializuar

Përpiluar në anglishte, më 15 shkurt 2019
Në Hagë, Holandë

¹ Vendim për caktimin e gjykatësve në një panel të Gjykatës Kushtetuese, KSC-CC-2019-05/F00002, 15 janar 2019. Një korrigjim i këtij vendimi u protokollua më 21 janar 2018, KSC-CC-2019-05/F00002/COR.

² Peticion i z. Mahir Hasani për konstatim të cenimit të të drejtave themelore të tij nga Zyra e Prokurorit të Specializuar përmes lëshimit të urdhrin VIY689 të datës 20 dhjetor 2018 për të paraqitur dokumente dhe të dhëna dhe kërkesë për masë të përkohshme, KSC-CC-2019-05/F00001, dorëzuar më 15 janar 2019, me tri shtojca konfidenciale ('Referimi'). Përkthimi në anglishte i Referimit u shpërnda më 18 janar 2019 (KSC-CC-2019-05/F00001/eng). Më 30 janar 2019 përkthimit iu bënë korrigjime (KSC-CC-2019-05/F00001/eng/COR).

³ Urdhër në lidhje me kërkesën e Mahir Hasanit për masë të përkohshme, KSC-CC-2019-05/F00010, 7 shkurt 2019.

⁴ *Shih, gjithashtu*, Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës ('GJKK'), rregulla 32(4); GJKK, Rasti KO 63/12, *Parashtruesit Alma Lama dhe të tjerë*, Vendim për heqje të kërkesës nga lista në Rastin KO 63/12, 10 dhjetor 2012, para. 23 ('Si parim i përgjithshëm procedural, Gjykata nuk duhet të nxjerrë vendime për raste kur çështja nuk ekziston më dhe rasti mbetet pa objekt shqyrtimi. Gjykatat nuk merren me raste hipotetike apo akademike. Ky është parim i pranuar botërisht për sjelljen e gjykatave dhe është analog me parimin e vetëpërmbytjes gjyqësore'), 24; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ'), neni 37(1); Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Ponomaryov & Others v. Bulgaria*, nr.5335/05, Vendim, 10 shkurt 2009, f.12, para.1.2.